



Prishtinë, 23 nëntor 2016

## **KOMUNIKATË**

### **SQARIME MBI ÇMIMET E ENERGJISË ELEKTRIKE**

**Struktura tarifore e çmimeve të energjisë elektrike e përcaktuar nga ZRRE ka për qëllim ti përshtatet sistemit elektro-energjetik në vend duke e nxitur kursimin e energjisë dhe duke mbrojtur konsumatorët me të ardhura më të ulëta**

Për shkak të reagimeve të shumta në lidhje me çmimet e energjisë elektrike, ZRRE dëshiron të sqarojë për të gjithë qytetarët se çmimet e energjisë elektrike për konsumatorët shtëpiak janë të njëjta që nga viti 2014. Përderisa Struktura Tarifore nuk ka ndryshuar që nga viti 2007.

Struktura e tanishme tarifore e energjisë elektrike është vendosur nga Bordi i ZRRE si zgjidhje për të përshtatur çmimet me karakteristikat e sistemit elektro-energjetik në vend, me qëllim të sigurimit të shërbimeve me çmime që mbulojnë kostot e arsyeshme të këtij sistemi.

ZRRE vazhdimisht është përpjekur të sqarojë për konsumatorët se duke filluar nga muaj tetor fillojnë tarifat e sezonit të lartë.

Arsyeja e ndarjes së tarifave sezonale është që të bëhet përshtatja me kërkesën e konsumit të energjisë elektrike e që me fillimin e sezonit të lartë konsumi i energjisë elektrike fillon të rritet dhe në të njëjtën kohë çmimet janë më të larta. Qëllimi i vendosjes së tarifës së sezonit të lartë është që të nxitet kursimi i energjisë elektrike gjatë muajve kur ngarkesa rritet dhe zvogëlohen mundësitë për të furnizuar të gjithë konsumatorët vetëm nga gjenerimi vendor. Në këtë mënyrë imponohet importi i energjisë me çmime më të larta.

Konsumatorët në sezonin e ulët paguajnë tarifa nën kosto mesatare të shërbimit, ndërsa e kundërta ndodh për sezonin e lartë.

ZRRE gjatë përcaktimit të strukturës tarifore, me qëllim që të nxisë konsumatorët ta kursejnë energjinë si dhe të mbrojnë konsumatorët me të ardhura më të ultë ka krijuar grupet tarifore. Blloku i parë tarifor aplikohet tek konsumatorët që kanë konsumin mujor deri në 200kWh; blloku i dytë tarifor aplikohet tek konsumatorët me konsum mujor nga 201kWh/muaj deri në 600 kWh dhe blloku i tretë tarifor aplikohet për konsumin mujor mbi 600 kWh.

Me këtë rast ZRRE ju bënë thirrje të gjithë konsumatorëve që ta kursejnë energjinë elektrike gjatë këtij sezoni. Rritja e konsumit, sidomos duke përdorur energjinë elektrike për ngrohje, mund t'i vendos ata në grup të konsumit më të lartë dhe duke pasur parasysh edhe diferencën nga çmimet e sezonit të ulët faturat e tyre mund të dyfishohen.



Bashkangjitur po ju përcjellim Strukturën e Tarifave me Pakicë të Energjisë Elektrike për konsumatorët e rregulluar të aprovuar nga Bordi i ZRRE, e që është e zbatueshme nga data 1 prill 2016 deri me 31 mars 2017.

Për çdo paqartësi për tarifa apo për faturat e energjisë, ZRRE lut konsumatorët që të kërkojnë sqarime nga Furnizuesi i tyre dhe nëse nuk janë të kënaqur me shërbimet që marrin të parashtrojnë ankesat e tyre në Zyrën e Rregullatorit për Energji, pranë Departamentit për mbrojtje të konsumatorëve.